



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më ____ . ____ . 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

**“PËR MIRATIMIN E SHESHIT “ALI ASLLANI” NË TERRITORIN E BASHKISË
VLORË”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/b, neni 54 pika II; me propozim të shoqatës “Shkrimtarëve dhe Artistëve” Dega Vlorë, datë 25.09.2024 të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë me Vendimin Nr.2 datë 20.11.2024, si dhe në relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.11.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e sheshit “Ali Asllani” në lagjen “Osman Haxhiu”, Rajoni 5, pranë Muzeut Etnografik, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më ____ . ____ . 2024

RELACION

MBI PROJEKTVE D D I M I N

“PËR MIRATIMIN E SHESHIT “ALI ASLLANI” NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË”

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë!

Ju paraqesim për miratim Projektvendimin “Për Miratimin e Sheshit “Ali Asllani” në Territorin e Bashkisë Vlorë” i cili është një propozim i shoqatës “Shkrimtarëve dhe Artistëve” Petro Marko Vlorë si dhe shoqata Atdhetare-Kulturore “Labëria” Dega Vlorë. Ky propozim është kërkuar të vlerësohet nga Këshilli i Bashkisë për këtë personalitet të shquar të historisë së qytetit të Vlorës. Qysh në vitin 2012, Bashkia Vlorë ka marrë vendimin që sheshi nga Sahati i Qytetit deri tek Muzeu Etnografik të ishin kufizimet të sheshit me emërtimin “Ali Asllani”. Por me ndryshimet e rikonstruksion të këtij territori, nuk është materializuar ky vendim dhe në këto kushte kërkohet nga propozuesit vendimmarrja e Këshillit për ta vendosur emërtimin e këtij sheshi “Ali Asllani” i cili sikurse dihet është një nga personalitetet më të shquara të qytetit të Vlorës.

Nisur nga fakti që për këtë personalitet të qytetit ka një vlerësim unanin për rolin e tij si Kryebashkiaku i parë i qytetit, propozojmë që të miratohet ky projektvendim.

Ky propozim është miratuar edhe nga Komisioni Këshillimor i Titujve Vendorë të Nderit i Këshillit të Bashkisë në datën 20.11.2024, Komision i cili gjithashtu propozon që ky projektvendim të miratohet nga Këshilli i Bashkisë.

Nga sa më lartë kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë të miratojë këtë projektvendim, si një vlerësim për këtë personalitet të shquar të qytetit të Vlorës por edhe në rang Këmbëtar.

Ju faleminderit

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri